



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 601/7 prot.

Elbasan, me 09.03.2022

VENDIM

Nr 13 datë 09.03.2022

**"PËR
SHPERBLIMIN E KOMISIONEVE TË POSAÇME NË UE"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM nr. 748 datë 11.06.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve,", VBA nr. 1, datë 05.01.2022 "Për detajimin e fondeve të miratuara për vitin 2022", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 05, datë 17.02.2021 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2022", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.03.2022

VENDOSI:

1. Të shpërblejë komisionet e posaçme dhe grupet e punës, të ngritura me VBA nr 39, datë 02.11.2021 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, me program të parë studimi, që përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, si studentë të shkëlqyer, studentë me rezultate dhe kërkesave me kritere të tjera", VBA nr 41, datë 02.11.2021 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, me program të parë studimi, që përfitojnë ulje nga tarifa vjetore e shkollimit, si studentë të shkëlqyer, studentë me rezultate dhe kërkesave me kritere të tjera", Urdhrit të Rektorit Nr. 17, datë 05.02.2018 "Për krijimin e Komisionit "Ad hoc" për plotësimin e dokumentacionit shkollor", për kryerjen e procedurave në UE, mbi detyrat funksionale të përcaktuara në Statutin e UE-së dhe në rregulloret përkatëse. Pagesa për secilin punonjës të jetë me nga 1 pagë mujore për 16 antarë personel, sipas emrave në aktet e cituara më lart. Çdo personel që është anëtar i më shumë se një komisioni do të paguhet vetëm një herë.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Ardian Darmishi